-Arkivi i zyrës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE
Ulaz-Izlazna
Nr. Br: 01-016-11249 Data Datum 23.03.2022
ISTOG-ISTOK

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-162/022	Data: Datum: 22.03.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit, për formim të komisionit për verifikimin e punëve për projektin: Lot 1"Ndërtimi i rrugës "Selim Brahimaj" në Shushicë" projekt 2 vjeçar, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-2587-5-2-1/C-458 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-020-521, nxjerr:

V E N D I M

1. FORMOHET: Komisioni për verifikimin e punëve për projektin: : Lot 1"Ndërtimi i rrugës "Selim Brahimaj" në Shushicë" projekt 2 vjeçar, me numër të jashtëm prokurimi 633-021-2587-5-2-1/C-458 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-021-020-521 të cilin projekt e ka realizuar operatori **"MENTI" SH.P.K** dhe në komision caktohen:

1.1. Naser Nimanaj,Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, Kryesues i Komisionit;
1.2. Blerim Bujupaj, Zyrtar për Ndërtimtari, anëtar dhe
1.3. Arta Fetahaj, Zyrtare për Planifikim dhe Zhvillim, anëtare.

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj kompaninë mbikëqyrëse "PMN''SH.P.K; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e pranimit teknik të projektit; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur; si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Komisioni ndërsa kompania mbikëqyrëse "PMN''SH.P.K merr përgjegjësin për pranimin e punëve.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Prokurimi.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Komisionit,
-"PMN''SH.P.K kompani mbikëqyrëse,
- Prokurimi,
- Drejtoria për Shërbime Publike,
-"Menti" SH.P.K-operator
-Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOK REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-161/022	Data: Datum: 21.03.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar ne nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62 i miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 05.Nr.149/2022 të datës 18.03.2022 të parashtruar nga z.Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtorisë Komunale për Arsim, nxjerr:

V E N D I M

1. **ANULOHET:** Konkursit 05 Nr.25/022 i publikuar me datën 25.01.2022 në ueb faqen zyrtare të komunës nga Drejtoria Komunale e Arsimit lidhur me plotësimin e vendeve të lira të punë për **një mësimdhënës/e për TIK, zëvendësim dhe tri pozita pune për Asistent/e për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.**

2. Të gjitha punët tekniko-administrative për anulim të këtij konkursi si në piken 1 të këtij Vendim do ti kryejë, Drejtoria Komunale e Arsimit.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale për Arsim.

4. Ky vendim është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Drejtorisë Komunale për Arsim;
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOK REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-159/022	Data: Datum: 18.03.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 34 paragrafin 12 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2019) dhe bazuar në nenin18 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shqyrtoi kërkesën me Nr.02-38/2022 të datës 18.03.2022 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për themelimin e Komisionit të pranimit për zhvillimin e procedurave të rekrutimit, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.02-38/2022 e datës 18.03.2022 e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për themelimin e Komisionit të pranimit për zhvillimin e procedurave të rekrutimit-pranim në kategori për pozitën **Zyrtar për Përkthime**, sipas konkursit të publikuar me datën 12.01.2022 dhe Komisioni i pranimit themelohet me këtë përbërje si me poshtë:

1.1. Fatmir Bytyçi, Menaxher i Personelit, Kryesues i Komisionit;
1.2. Jehona Arifaj, Udhëheqëse e Qendrës për Shërbim me Qytetar, anëtare;
1.3. Esad Smakić, Zyrtare për Buxhet dhe Financa 2, anëtar;
1.4. Faton Bujupi, Zyrtar Ligjor 2, anëtar dhe
1.5. Haxhi Metaj, Ekspert i Jashtëm, anëtar.

3. Punët e Komisioni të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e kujdeset: Komisioni.

6. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Komisionit të pranimit;
-Zyrës personelit dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOK REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-158/022	Data: Datum: 18.03.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 34 paragrafin 12 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2019) dhe bazuar në nenin18 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shqyrtoi kërkesën me Nr.02-41/2022 të datës 18.03.2022 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për themelimin e Komisionit të pranimit për zhvillimin e procedurave të rekrutimit, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.02-41/2022 e datës 18.03.2022 e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për themelimin e Komisionit të pranimit për zhvillimin e procedurave të rekrutimit-pranim në kategori për pozitën **Zyrtar Ligjor 1**, sipas konkursit të publikuar me datën 11.01.2022 dhe Komisioni i pranimit themelohet me këtë përbërje si me poshtë:

1.1. Fatmir Bytyçi, Menaxher i Personelit, Kryesues i Komisionit;
1.2. Arlinda Kurtaj, Udhëheqëse e Sektorit për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete, anëtare;
1.3. Enisa Ćorović, Zyrtare për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komuniteteve, anëtare;
1.4. Faton Bujupi, Zyrtar Ligjor 2, anëtar dhe
1.5. Haxhi Metaj, Ekspert i Jashtëm, anëtar.

3. Punët e Komisioni të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e kujdeset: Komisioni.

6. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Komisionit të pranimit;
-Zyrës personelit dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-157/022	Data: Datum: 18.03.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 34 paragrafin 12 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2019) dhe bazuar në nenin18 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shqyrtoi kërkesën me Nr.02-37/2022 të datës 18.03.2022 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për themelimin e Komisionit të pranimit për zhvillimin e procedurave të rekrutimit, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.02-37/2022 e datës 18.03.2022 e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për themelimin e Komisionit të pranimit për zhvillimin e procedurave të rekrutimit-pranim në kategori për pozitën **Zyrtar për Kadastër**, sipas konkursit të publikuar me datën 13.01.2022 dhe Komisioni i pranimit themelohet me këtë përbërje si me poshtë:

1.1. Fatmir Bytyçi, Menaxher i Personelit, Kryesues i Komisionit;
1.2. Bushat Gashi, Zyrtar për Kadastër, anëtar;
1.3. Enisa Ćorović, Zyrtare për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komuniteteve, anëtare;
1.4. Gëzim Ademaj, Udhëheqës i Prokurimit, anëtar dhe
1.5. Haxhi Metaj, Ekspert i Jashtëm, anëtar.

3. Punët e Komisioni të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e kujdeset: Komisioni.

6. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Komisionit të pranimit;
-Zyrës personelit dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA KOSOVO KOMUNA E ISTOKUT OPŠTINA ISTOK

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-156/022	Data: Datum: 18.03.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 34 paragrafin 12 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2019) dhe bazuar në nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shqyrtoi kërkesën me Nr.02-39/2022 të datës 18.03.2022 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për themelimin e Komisionit të pranimit për zhvillimin e procedurave të rekrutimit, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.02-39/2022 e datës 18.03.2022 e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për themelimin e Komisionit të pranimit për zhvillimin e procedurave të rekrutimit-pranim në kategori për pozitën **Zyrtar për Shërbim me Qytetar**, sipas konkursit të publikuar me datën 27.01.2022 dhe Komisioni i pranimit themelohet me këtë përbërje si me poshtë:

1.1. Fatmir Bytyçi, Menaxher i Personelit, Kryesuese e Komisionit;
1.2. Jehona Arifaj, Udhëheqëse e Qendrës për Shërbim me Qytetar, anëtare;
1.3. Enisa Ćorović, Zyrtare për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komuniteteve, anëtare;
1.4. Gjevahire Ibrahimaj, Zyrtare për Arkiv 1 në QSHQ, anëtare dhe
1.5. Haxhi Metaj, Ekspert i Jashtëm, anëtar.

3. Punët e Komisioni të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e kujdeset: Komisioni.

6. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Komisionit të pranimit;
-Zyrës personelit dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-155/022	Data: Datum: 18.03.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 34 paragrafin 12 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2019) dhe bazuar në nenin 18 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shqyrtoi kërkesën me Nr.02-40/2022 të datës 18.03.2022 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për themelimin e Komisionit të pranimit për zhvillimin e procedurave të rekrutimit, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.02-40/2022 e datës 18.03.2022 e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për themelimin e Komisionit të pranimit për zhvillimin e procedurave të rekrutimit-pranim në kategori për pozitën **Zyrtar për Tatimin në Pronë**, sipas konkursit të publikuar me datën 12.01.2022 dhe Komisioni i pranimit themelohet me këtë përbërje si me poshtë:

1.1. Fatmir Bytyçi, Menaxher i Personelit, Kryesuese e Komisionit;
1.2. Hatixhe Arifaj, Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë, anëtare;
1.3. Enisa Ćorović, Zyrtare për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komuniteteve, anëtare;
1.4. Gani Sylaj, Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa, anëtar dhe
1.5. Haxhi Metaj, Ekspert i Jashtëm, anëtar.

3. Punët e Komisioni të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L -114 për Zyrtarët Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do t'i kryejë Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e kujdeset: Komisioni.

6. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Komisionit të pranimit;
-Zyrës personelit dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOK REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.150/2022	Data: 17.03.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 67 paragrafi 1 nënpragrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenin 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë Komunale për Arsim 05.Nr.142/2022 të datës 16.03.2022, për kompenzimin në lartësi prej 3(tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Ramadan Balaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Biologjisë dhe Kimisë në SHFMU "Fan.S.Noli" në fsh Llukac i Begut, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 05.Nr.142/2022 të datës 16.03.2022 e parashtruar nga Drejtoria Komunale për Arsim për kompensimin në lartësi prej 3 (tri) pagave mujore qe i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Ramadan Balaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Biologjisë dhe Kimisë në SHFMU "Fan.S.Noli" në fsh Llukac i Begut.

2. Mësimdhënësit të lartpërmendur i përfundon shërbimi me **28.04.2022**.

3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.

4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime në Drejtorinë Komunale për Arsim, obligohet që Ramadan Balaj, t`ia bëjë pagesën e 3(tri) pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale për Arsim dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Inspektoratit të Punës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
-Ramadan Balaj,
-Drejtorisë Komunale për Arsim;
-Zyrtarit Financiar për Paga, Mëditje dhe kompensime dhe
-Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOKUT OPŠTINA ISTOK REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.149/2022	Data: 17.03.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 67 paragrafi 1 nënpragrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenin 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë Komunale për Arsim 05.Nr.141/2022 të datës 16.03.2022, për kompenzimin në lartësi prej 3(tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Xhemile Bardhecaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Gjuhës Shqipe në SHFMU "Bajram Curri" në Istog, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 05.Nr.141/2022 të datës 16.03.2022 e parashtruar nga Drejtoria Komunale për Arsim për kompensimin në lartësi prej 3 (tri) pagave mujore qe i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Xhemile Bardhecaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Gjuhës Shqipe në SHFMU "Bajram Curri" në Istog.

2. Mësimdhënësit të lartpërmendur i përfundon shërbimi me **16.04.2022**.

3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.

4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime në Drejtorinë Komunale për Arsim, obligohet që Xhemile Bardhecaj, t`ia bëjë pagesën e 3(tri) pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale për Arsim dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Inspektoratit të Punës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Xhemile Bardhecaj,
-Drejtorisë Komunale për Arsim;
-Zyrtarit Financiar për Paga, Mëditje dhe kompensime dhe
-Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOK REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.148/2022	Data: 17.03.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 67 paragrafi 1 nënpragrafi 1.4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.90/2010), nenin 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2014) data e publikimit 18.06.2014, shqyrtoi kërkesën e Drejtorisë Komunale për Arsim 05.Nr.140/2022 të datës 16.03.2022, për kompenzimin në lartësi prej 3(tri) pagave mujore për përfundimin e shërbimit-pensionimit të Qerim Rexhaj, me titull të postit: Mësimdhënës i Gjuhës Shqipe në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 05.Nr.140/2022 të datës 16.03.2022 e parashtruar nga Drejtoria Komunale për Arsim për kompensimin në lartësi prej 3 (tri) pagave mujore qe i ka marr për tre (3) muajt të fundit për përfundimin e shërbimit-pensionimit të **Qerim Rexhaj,** me titull të postit: Mësimdhënës i Gjuhës Shqipe në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog.

2. Mësimdhënësit të lartpërmendur i përfundon shërbimi me **04.04.2022**.

3. Pagesa e mjeteve të cekura nga pika 1 e këtij Vendimi, do të bëhet nga programi buxhetor i Drejtorisë Komunale për Arsim.

4. Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompensime në Drejtorinë Komunale për Arsim, obligohet që Qerim Rexhaj, t`ia bëjë pagesën e 3(tri) pagave mujore që i ka marrë për tre (3) muajt të fundit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria Komunale për Arsim dhe Zyrtari Financiar për Paga, Mëditje dhe Kompenzime.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa Inspektoratit të Punës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
-Qerim Rexhaj,
-Drejtorisë Komunale për Arsim;
-Zyrtarit Financiar për Paga, Mëditje dhe kompensime dhe
-Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOK REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.146/2022	Data: 17.03.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale publikuar në (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) dhe nenin 69, paragrafi 69.1, pika 4 e Statutit të Komunës 01 Nr. 62/10 të datës 30.11.2010 lidhur me formimin e Komisionit për Verifikimin dhe Përpilimin e Listës së Veçantë të Pronave të Paluajtshme të Komunës me qëllim të dhënies së tyre në shfrytëzim për vitin 2022, merr këtë:

VENDIM

1. Formohet *Komisioni i Komunës për Verifikimin dhe Përpilimin e Listës së Veçantë të Pronave të Paluajtshme të Komunës* dhe publikim e tyre në ueb faqen e Komunës me qëllim të dhënies së tyre në shfrytëzim për vitin 2022 dhe në të caktohen:

1. **Agon Dreshaj,** Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezisë dhe Kadastër;
2. **Dukagjin Hoxhaj,** Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis;
3. **Genc Ademaj,** Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik;
4. **Fadil Kabashi,** Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
5. **Kushtrim Buleshkaj,** Drejtor i Drejtorisë për Inspekcion.

2. Komisioni i lartcekur ka për detyrë të verifikojë dhe përpilojë listën e veçantë me pronat e paluajtshme të komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim për vitin 2022. Me rastin e përpilimit të kësaj liste komisioni duhet të merr parasysh zhvillimin ekonomik dhe interesin publik të Komunës në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019), Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe ligjet tjera përkatëse në fuqi.

3. Lista e veçantë me pronat e paluajtshme të komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim për vitin 2022 i paraqitet Kuvendit të Komunës për miratim dhe është e vlefshme vetëm me miratimin nga ana e Kuvendit të Komunës.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtoria e Inspekcionit.

Vendimi iu dorëzohet: Zyrës së Kryetarit, Drejtorive përkatëse të lartcekura dhe Arkivës.

Udhëheqësja e Zyrës Ligjore
Zekije Sutaj

Kryetari i Komunës
Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOK REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-145/2022	Data: Datum: 16.03.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve për përkrahje financiare në shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-10176 të datës 15.03.2022, të parashtruar nga z.Sulo Ahmetaj nga Gurakoci, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për marrjes e kimioterapisë në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

VENDIM

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-10176 e datës 15.03.2022 e parashtruar nga **z.Sulo Ahmetaj** për përkrahje me karburant, për marrjes e kimioterapisë në QKUK në Prishtinë dhe i lejohen 50 litra karburant.
2. Obligohet Zyrtari i transportit që z.Sulo Ahmetaj të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Sulo Ahmetaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-10176 e datës 15.03.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i tij në QKUK- Prishtinë për marrjen e kimioterapisë.
Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.
Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Sulo Ahmetaj është i sëmurë nga kanceri dhe i ndihmohet me 60 litra karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e tij për marrjen e kimioterapisë në QKUK në Prishtinë.
I lartpërmenduri është në gjendjen ekonomiko sociale jo të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij për rrezatime në Prishtinë.
Zyrtari i transportit Sulon do të pajisë më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejnë edhe për automjetet zyrtare.
Drejtoria për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.
Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
-z.Sulo Ahmetaj,
-Drejtorisë për Shëndetësi,
-Zyrtarit të Transportit dhe
-Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-144/2022	Data: Datum: 16.03.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 16.03.2022 për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit: "Riparimi i rrugëve lokale të rendit të IV", me numër të jashtëm prokurimi 633-022-1009-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-005-121, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit: "Riparimi i rrugëve lokale të rendit të IV", me numër të jashtëm prokurimi 633-022-1009-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-005-121 dhe në komision caktohen:

1.1. Naser Gjocaj, Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, Kryesues i Komisionit;
1.2. Shefqet Imeraj, Zyrtar i Prokurimit, anëtar dhe
1.3. Isa Hoxhaj, Zyrtar i Lartë për Efiçencë të Energjisë, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e tenderit: "Riparimi i rrugëve lokale të rendit të IV", me qellim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtaret e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtaret e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtaret e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit dhe Prokurimi t`iu ofroj qasje në ofertave qe kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Komisionit,
-Prokurimit,
-Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOK REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-143/2022	Data: Datum: 16.03.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 16.03.2022 për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit: Lot 1"Servisimi dhe riparimi i rëntgen aparatit; Lot 2"Servisimi dhe riparimi karrigeve stomatologjike"; Lot 3"Servisimi dhe riparimi i pajisjeve laboratorike", me numër të jashtëm prokurimi 633-022-768-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-004-221, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit: Lot 1"Servisimi dhe riparimi i rëntgen aparatit; Lot 2"Servisimi dhe riparimi karrigeve stomatologjike"; Lot 3"Servisimi dhe riparimi i pajisjeve laboratorike", me numër të jashtëm prokurimi 633-022-768-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-004-221dhe në komision caktohen:

1.1. Brahim Hetemaj, Udhëheqës i Sektorit për Shëndetësi, Kryesues i Komisionit;
1.2. Fisnik Shoshi, Zyrtar Ligjor 2, anëtar dhe
1.3. Kastriot Idrizaj, Zyrtar i të hyrave në QKMF, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e tenderit: Lot 1"Servisimi dhe riparimi i rëntgen aparatit; Lot 2"Servisimi dhe riparimi karrigeve stomatologjike"; Lot 3"Servisimi dhe riparimi i pajisjeve laboratorike", me qellim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtaret e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtaret e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtaret e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit dhe Prokurimi t`iu ofroj qasje në ofertave qe kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Komisionit,
-Prokurimit,
-Drejtorisë për Shëndetësi dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOK REPUBLIKA KOSOVA

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-141/022	Data: Datum: 14.03.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe nenit 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2020 i miratuar me datë 30.11.2010, nxjerr:

V E N D I M

1. **SHFUQIZOHET:** pjesërisht Vendimi 01Nr.03/2022 i datës 06.01.2022 vetëm autorizimi për **z.Abedin Neziraj,** me titull të pozitës së punës Zyrtar për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komuniteteve në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim për nënshkrimin e dokumenteve të kësaj Zyre nga data 24.02.2022.

2. **Rasim Mahmutović,** është kthyer në vendin e punës Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim me datë 24.02.2022 sipas vendimit 01 Nr.114/022 të datës 01.03.2022.

3. Ky Vendim hyrë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Abedin Neziraj.

4. Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:
-Abedin Neziraj,
-Rasim Mahmutović dhe
-Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVO KOMUNA E ISTOKUT OPŠTINA ISTOK

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-140/2022	Data: Datum: 11.03.2022	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-8854 të datës 07.03.2022, të parashtruar nga z.Armend Hajzeraj nga fsh. Syriganë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e babait Sherif Hajzeraj në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-8854 e datës 07.03.2022 e parashtruar nga **z.Armend Hajzeraj** për përkrahje me karburant, për dërgimin e babait Sherif Hajzeraj për ti kryer 35 rrezatime në QKUK në Prishtinë dhe i lejohen 350 litra karburant.
2. Obligohet Zyrtari i transportit që të pajisë z.Armend Hajzeraj, për çdo javë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit deri në përfundimin e rrezatimit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Armend Hajzeraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-8854 të datës 07.03.2022, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i babit të tij në QKUK- Prishtinë për rrezatime.
Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.
Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se Sherif Hajzeraj është i sëmurë nga kanceri dhe i ndihmohet me 350 litra karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e tij për rrezatime në QKUK në Prishtinë.
I lartpërmenduri është në gjendjen ekonomiko sociale jo të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij për rrezatime në Prishtinë.
Zyrtari i transportit Armendin do të pajisë për çdo javë më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejnë edhe për automjetet zyrtare.
Drejtoria për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.
Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
-z.Armend Hajzeraj,
-Drejtorisë për Shëndetësi,
-Zyrtarit të Transportit dhe
-Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOK REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-138/2022	Data: Datum: 11.03.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 10.03.2022 për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit: "Ndërtimi i deponisë në Tuçep", me numër të jashtëm prokurimi 633-022-1118-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-006-121, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit: "Ndërtimi i deponisë në Tuçep", me numër të jashtëm prokurimi 633-022-1118-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-022-006-121 dhe në komision caktohen:

1.1. Naser Nimanaj, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, Kryesues i Komisionit;
1.2. Blerim Bujupi, Zyrtar për Ndërtimori, anëtar dhe
1.3. Shefqet Imeraj, Zyrtar i Prokurimit, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e tenderit: "Ndërtimi i deponisë në Tuçep", me qellim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtaret e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Obligohen anëtaret e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit dhe Prokurimi t`iu ofroj qasje në ofertave qe kanë shprehur konkurrencë.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

7. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Komisionit,
-Prokurimit,
-Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

Republika e Kosovës Republika Kosovo Republiç of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-138/2022	Data: Datum: 11.03.2022	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2020 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 01Nr.016-7428 të datës 24.02.2022 të parashtruar nga Policia e Kosovës njësia në Istog, për themelimin e Komisionit për dalje në vend ngjarje në magjistralen Mitrovicë-Pejë për vlerësimin e intervenimeve në infrastrukturës, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për dalje në vend ngjarje në magjistralen Mitrovicë-Pejë për vlerësimin e intervenimeve në infrastrukturës me qellim të lëvizjes së sigurt të pjesëmarrësve në trafik për uljen e aksidenteve në ketë pjesë të rrugës dhe në komision caktohen:

1.1. **Naser Nimanaj,** inxh. i komunikacionit-Zyrtar i Lartë për Transport, Kryesues i Komisionit;
